

Republika e Kosoves

Projekti i Bankes Boterore: Rritja/permiresimi e implementimit te Prokurimit Publik

(IDF Grant No. TF013655)

Sherbime keshilluese/komponenta: Matja e pajtueshmerise dhe monitorimi i performances se njesive te prokurimit dhe stafit te prokurimit ne perputhje me sistemin e prokurimit publik ne Kosove

Raport

Monitorimi i performances dhe pajtueshmerise se sistemit te prokurimit publik ne Kosove

Dhjetor 2015

Prishtine, Kosove

Tabela e Permbajtjes

Lista e Shkurtesave	3
Kapitulli I.....	4
1 Permbledhje Ekzekutive	4
1.1 Hyrje	5
1.2 Objektivat e MP&MP	7
1.3 Qellimi i MP&MP.....	7
1.4 Permbajtja e Raportit	7
Kapitulli II	8
2. Metodologja	8
2.1 Zhvillimi/vendosja e Indikatoreve kyc per matjen e performances.....	8
2.2 Zgjedhja e AK per MP&MP	9
2.3 Raporti i kontratave te nenshkuara nga AK.....	10
2.3.1 Totali i kontratave te AK te monitoruara sipas llojit/kategorise.....	12
2.3.2 Totali i kontratave te AK te monitoruara sipas metodave te prokurimit	12
2.4 Inventari i rasteve te monitoruara te prokurimit	13
2.5 Instrumentet/mjetet e mbledhjes se te dhenave	15
2.6 Burimet e te dhenave	15
Kapitulli III.....	15
3.Te gjeturat nga MP&MP.....	15
3.1 Informacioni baze mbi kontratatat e monitoruara.....	15
3.2 Te gjeturat sipas Indikatoreve kyc te performances	16
3.2.1 Faza para-tenderimit	16
3.2.2 Procesi i prokurimit.....	21
3.2.3 Menagjimi i kontrates	24
3.2.4 Plotesia e te dhenave ne nje register te prokurimit	26
Kapitulli IV	27
4 Konkluzione & Rekomandime	27

Listë e Shkurtesave

LPP	– Ligji i Prokurimit Publike
UOP	- Udhezuesi Operativ I Prokurimit Publike
RPP	- Rregullorja e Prokurimit Publike
KRPP	- Komisioni Regullative I Prokurimit Publike
BB	- Banka Boterore
BE	– Bashkimi Europian
OSHP	- Organi Shqyrtares I Prokurimit Publike
AQP	- Agjencioni Qendrore I Prokurimit Publike
AK	– Autoritetet Kontraktuese
PP	– Procedurat e Prokurimit
BKK	– Buxheti i Konsoliduar i Kosoves
MP&MP	- Matja e Performances dhe Monitorimi i Pajtueshmerise se PP
IKPP	– Indikatori Kyc i Performances & Pajtueshmerise
MF	- Ministria e Financave
MeD	- Ministria e Diaspores
MD	– Ministria e Drejtësise
MMPH	– Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapesinore
KOSTT	- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a
UP	– Universiteti i Prishtines
ANP	– Aeroporti Nderkombetare i Prishtines
PTK	- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosoves
KK	– Kuvendi Komunal
PNPPNJK	- Procedure e Negociuar pa Publikimin e Njoftimit per Kontrate

Kapitulli I

1 Permbledhje Ekzekutive

Qeveria e Kosoves ne vazhdimesi eshte duke bere perpjekje ne zbatimin e reformave ne sektorin e prokurimit publik. Megjithate pavaresisht reformave te theksuara ne anen legislative, implementimi ne praktike i ketij legjislacioni i konsideruar i avancuar ende mbetet nje sfide.

LPP, percakon qarte KRPP, si nje organe te pavarur legislative, monitories dhe mbikqyres ne fushen e Prokurimit Publike ne Kosove. KRPP, duke perfituar nga nje Grant i Bankes Boterore dhene Qeverise se Kosoves, per: Rritja/permiresimi i implementimit te Prokurimit Publik si dhe rritjen e transparences dhe integritetit te kontratave publike ne Kosove (IDF Grant No. TF013655), draftoi nje Manual gjithperfshires duke vene keshtu per here te pare bazat e nje sistemit te monitorimit te performances dhe pajtueshmerise te prokurimit publik ne Kosove. Si rezultat, ne fund te vitit 2014, u draftua raporti i pare i monitorimit te pajtueshmeris dhe matjes se performances se Sistemit te Prokurimit Publik ne Kosove.

Ky eshte raporti i dyte i monitorimit te performances dhe pajtueshmerise se prokurimit publik ne Kosove, i vitit te dyte te implementimit te projektit te cekur me larte.

Mbledhja e te dhenave per kontratat e prokurimit u be per vitet 2014/2015. Viti 2014 u mor per raste qe kanë filluar në 2014 dhe qe ne vitin 2015 jane ne procesin e implementimit te kontratave. Mbledhja dhe agregimi i te dhenave nga aktivitetet e monitoruara u be duke u bazuar ne metodologjine e njejte si ne vitin e pare, si: zgjedhja e AK, per te u monitoruar u be duke identifikuar ato AK, te konsideruar si shfrytezues me te medhenje te BKK (te ndryshme nga viti i meparshem), ndersa zgjedhja e rasteve te prokurimit qe duhet të monitorohen te AK, eshte bere duke u bazuar ne te dhenat nga raportet e kontratave te nenshkuara gjate vitit 2014 nga AK dhe dorezuar ne KRPP.

Informacioni i mbledhur nga monitorimi i pajtueshmerise dhe performances se prokurimit publike eshte per te konstatuar performancen e sistemit te prokurimit publik në Kosove duke identifikuar mangesite e ketij sistemi, fushat kryesore te identikuara si te mangeta dhe qe kerkojne intervenime per permiresim ose edhe mbeshtetje shtese nga Qeveria e Kosoves. Gjithashtu ky monitorim i prokurimit publik eshte per te lehtesuar perqatitjen e raporteve te partnereve te ndryshem qe mbeshtesin Qeverine e Kosoves ne berjen e reformave ne sektorin e financave publike ne perqitjen dhe ne ate te prokurimit publik ne vecanti.

Matja e performances dhe pajtueshmerise se sistemit te prokurimit publike ne Kosove, u bazua edhe kete vite ne 4 fusha kryesore te performances si ne 13 -indikatoret kyc dhe 24 -sub

indikatore, me ane te te cileve mund te agregohen te dhenat e mbledhura nga te gjitha Departamentet e Prokurimit te AK (stafi i prokurimit) si dhe nga pergjegjesit e tjere sipas funksionit te tyre ne kuader te AK, ashtu siq eshte i ndertuar sistemi i Prokurimit Publik ne Kosove.

Gjate implementimit te vitit te dyte te projektit u arrit qe te behet bartja e njojurive tek stafi i Departamentit te Monitorimit te KRPP. U arrit nje qasjee re sa i perket metodologjise se monitorimit te prokurimit publik, si ne aspektin e monitorimit te pajtueshmerise ashtu edhe ne ate te performances.

U be nje plotesim i formularit se Raportimit vjetore per kontratat e nenshkruara te AK (kerkese kjo ligjore), ne KRPP, duke vendosur me shume Indikatore mates per mbledhjen e te dhenave ne menyre qe ne fund te cdo viti te sigurohen te dhenat e nevojshme per nje monitorimin gjithperfshires te PP ne Kosove.

1.1 Hyrje

Qeveria e Kosoves ne vazhdimesi eshte duke ber perpjekje ne zbatimin e reformave ne sektorin e prokurimit publik. Ne vazhdimesi u zhvillua nje kornize legjislatieve dhe u ndertua nje sistem gjithperfshires i prokurimit publik. Sidomos u arrit nje zhvillim i kenaqshem ne anen legjislatieve te prokurimit publik ku ne vitin 2012 ,rezultoi me nje kornize legjislatieve gjithperfshires, si nje LPP ne mase te madhe kompatibile me direktivat e BE-se dhe me nje legjislacion percelles dytesore pothuajse te kompletuar.

Edhe pse KRPP, qe nga themelimi zbaton nje metodologji te monitorimit te prokurimit publik me gjithate sistemi ekzistues ka një numer të meta, duke përfshire:

- Deri me tani, eshte bere nje monitorimin i pajtueshmerise se aktiviteteve te prokurimit te zhvilluara nga AK, me Kornizen legjislatieve te prokurimit publik dhe nuk eshte verejtur asnjë rast i monitorimit të performances se AK, perkatesisht zyrtareve te prokurimit. Si çeshtje primare, monitorimi i performances dhe ai i menaxhimit të kontratave duhet të përfshihet në çfaredo monitorimi ne te ardhmen.
- Monitorimi i menaxhimit të kontrates ka filluar te behet por eshtë larg nivelit te kerkuar. Kjo pjese do te trajtohet ne menyre serioze dhe permiresime duhet te behen. Sidomos keto ceshtje duhet te adresohen tek Menagjmenti i larte i KRPP ne ngritjen e kapaciteve administrative ne kete fushe dhe gjithashtu tek Menagjmenti me i larte i AK-se.
- Monitorimi i aktiviteteve ne vijim-proces ("rastet e gjalla"), është bere por ne një numer të vogel.

- Raportet e monitorimit jane shume formale dhe nuk përfshijne shume informata të nevojshme. Me shume janë monitorime kuantitative se sa kualitative. Si rezultat nga keto raporte ende nuk ka një pasqyre te per gjitshmë ne lidhje me ate si si eshte duke u implementuar prokurimi publike ne Kosove duke bere identifikimi e mangesive ose pikave te dobeta dhe adresimin e duhur te tyre si dhe masat qe duhet te mirren per tu permiresuar. Korrigjime të nevojshme do të bëhen, dhe kjo ceshtje adresohet tek KRPP.

Ne menyre qe te qe te kemi një identifikim te mangesive te cekura si ma larte dhe te tjera dhe një adresim te ketyre mangesive si dhe dhenien e rekomandimeve per permiresimi si dhe si te ecet me tutje KRPP, udhehoqi zhvillimin dhe vendosjen e një sistemi gjithperfshires te MP&MP, duke vendosur Indikatoret kyc te performances bashke me objektivat dhe synimet qe mendohet te arrihen.

MP&MP, eshte një monitorim dhe vleresim i thelle i sistemit te prokurimit publike ne Kosove, ne menyre qe te behet identifikimin i fushave te dobeta dhe atyre te forta si dhe duke dhene drejtimin e duhur reformave qe jane te nevojshme ne fushen e prokurimit publik ne planin afatshkurger dhe ne ate afatgjate.

- Rezultatet e arritura pas vitit te dyte te implementimit te projektit ishin:
- Reforma në anën legislative të prokurimit publikë, si: ndryshimi i LPP. Kjo edhe si rezultat i identifikimit te dobësive dhe përparësive në zbatimin e LPP dhe legjisacionit përcelles ose sistemit të prokurimit publik në per gjithesi gjate vitit te pare te matjes se performances.
- Reformat në anën operacionale të permirësimit të zbatimit të LPP, si:
- monitorimi i publikimeve te njoftimeve per kontrate si fillim monitorimi i kontratave me vlera të medha ndersa tani monitorimi i te gjitha publikimeve të njoftimeve për kontratë të ardhura në KRPP.
- ndryshimi i mënyrës së raportimit te AK ne KRPP, duke synuar mbledhjen e me shume te dhënavë si dhe përmirësim në cilesin e raporteve individuale te monitorimit te AK të leshuara nga KRPP.
- Nje casje e re e ndryshuar në kuadër te vet procesit te monitorimit të prokurimit publikë nga KRPP duke i dhënë prioritet monitorimit preventiv.
- Mundësia se si prokurimi elektronik mund të gjeneroje të dhëna për monitorimin e prokurimit publike ne Kosove duke synuar një monitorim sa me efikas (ne proces).

1.2 Objektivat e MP&MP

Objektivat e MP&MP, janë në përputhje me një nga funksionet kryesore të KRPP, sipas nenit 88 te LPP, i cili i jep autoritetin dhe perjegjesine, qe te:

- Te vezhgoje dhe mbikqyre implementimin e prokurimit publik si dhe te pergatise raporte qe identifikojne perparesite dhe dobesite ne zbatimin e LPP dhe legjislacionit percjelles ose sistemit te prokurimit ne perjithesi ne menyre qe te ipet një vleresim i perjithshem por i sakte i gjendjes se sistemit kombetar te prokurimit si dhe vleresime te veçanta te shkalles se perputhjes/mosperputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese si dhe te beje rekomandimet e duhura per permiresim.

1.3 Qellimi i MP&MP

Qellimi i MP&MP , eshte per te gjeneruar te dhenat baze mbi fushat kyce te MP&MP, se prokurimit mbi te cilat mund te bazohet permiresimi i sistemit te kombetare te prokurimit publik.

Nje qellim tjeter kryesor i MP&MP, eshte gjithashtu per te ju mundesar te gjitha paleve te interesuara ne Sistemin e prokurimit ne Kosove, per te fituar një fokus me te qarte ne ato fusha kyce ku funksionimi i prokurimit ka nevoje per te u permiresuar dhe ne kete menyre te fokusohet ne keto fusha ne kuadrin e një programi qe synon rritjen e pajtueshmerise gjate implementimit te aktivitetave te prokurimit nga AK si dhe ngritje te kapaciteteve ne prokurimin publik aty ku eshte e nevojshme.

1.4 Permbajtja e Raportit

Ky report eshte i ndare ne 4 kapituj, te cilet mbulojne fushat, si ne vijim:

1. **Hyrje:** Kjo pjese mbulon zhvillimin dhe vendosjen e Sistemit te MP&MP;
2. **Metodologjia:** Kjo pjese mbulon procesin e zhvillimit te indikatoreve kyç te pajtueshmerise dhe performances; kryerja e matjes/vleresimit; zgjedhjen e AK qe jane monitoruar; inventari i lendeve te monitoruara si dhe procedurat per percaktimin e saj; instrumentet e matjes se performances;
3. **Te gjeturat:** Kjo pjese mbulon gjetjet nen kater fushat kryesore te matjes se performances si: faza-para tenderuese, procesi apo zhvillimi i aktivitetit te prokurimit, ekzekutimi/implementimi i kontrates si dhe regjistri i te dhenave te prokurimit publik.
4. **Konkluzione dhe Rekomandime.** Kjo pjese mbulon konkluzionet dhe rekomandimet qe dalin nga MP&MP, si dhe si te vazhdohet me tutje.

Kapitulli II

2. Metodologja

2.1 Zhvillimi/vendosja e Indikatoreve kyc per matjen e performances

Pjesa e VI, e LPP (neni 88), i jep KRPP, autoritetin dhe pergjegjesine te monitoroje dhe ne baze te kesaje te raportoje per sistemin e prokurimit publike ne Kosove si dhe te rekomandoje per permiresime dhe intervenime ne fushat e identikuara me mangesi ne kete sistem ne menyre qe gjate zhvillimit te aktiviteteve te prokurimit nga AK, te zbatohet Korniza legislative e prokurimit publik si dhe te ndihmoje ne vendosjen e standardeve dhe praktikave me te mira ne kete fushe.

Te gjitha aktivitetet dhe rezultatet e AK dhe stafit te prokurimit gjate kryerjes se aktiviteteve te prokurimit pritet te rezultojne ne rezultatet kryesore ne arritje te: efikasitetit, efektivitet, transparencies (anti korruption) dhe vleres per para. Keto jane edhe parimet kryesore te prokurimit publik sipas LPP. Andaj fokusi i ndertimit te nje MP&MP te sistemit te prokurimit publik ishte i orientuar ne vendosjen e indikatoreve mates kyc duke percaktuar objektivat e tyre si dhe qellimet/synimet qe deshirohet te arrihen.

Ne vijim janë 4 fushat kryesore te pajtueshmerise dhe performances që janë identifikuar per vitin e pare te MP&MP (ose 4 IKPP) dhe qe vazhduan edhe ne vitin e dyte.

IKPP-I : procedura para-tenderimit

Nen kete zone kyç te pajtueshmerise dhe performances, Indikatoret dhe rezultatet në vijim do te jene te matur, nga:

- Percaktimi i vleres se parashikuar te kontrates
- Planifikimi i prokurimit
- Lloji i procedures se prokurimit
- Pregaditja e dosjes se tenderit

IKPP-II: Procesi i prokurimit.

Nen kete zone kyç të performances, Indikatoret dhe rezultatet ne vijim do te jene te matur, nga:

- DNVDM, e plotesuar konform kerkesave ligjore
- Aplikimi i metodave te prokurimit
- Publikimet e njoftimeve per kontrate jane te bera dhe konform kerkesave te LPP

- Procesi i vleresimit
- Pjesemarrja e operatoreve ekonomike ne aktivitetet e prokurimit
- Kohezgjatja e nje aktiviteti te prokurimit

IKPP-III: Ekzekutimi/implementimi i kontrates

Nen kete zone kyç të performancëe, Indikatoret dhe rezultatet në vijim do te jene te matur, nga:

- Aktivitetet e menagjimit te kontrates jane konform kerkesave ligjore
- Kontratat shtese

IKPP-IV-Regjistri permbledhes i prokurimit publike:

Nen kete zone kyç të performancëe, Indikatoret dhe rezultatet në vijim do te jene te matur, nga:

- Regjistri permbledhes i aktivitetit perkates te prokurimit permbane te gjitha te dhenat konform LPP dhe UOP.

Tabela 1: Numri i IKPP dhe nen-indikatoret

Fusha kyçë te pajtueshmerise/ performances	Nr. i Indikatoreve	Nr. i nen-indikatoreve
I: Faza para-tenderuese	4	7
II: Procesi i prokurimit	6	11
III: Menaxhimi i kontrates	2	5
IV: Regjistri i prokurimit publik	1	1
Totali:	13	24

2.2 Zgjedhja e AK per MP&MP

Zgjedhje AK per te u monitoruar gjate vitit te dyte te implementimit te projektit u be ne bashkepunim me DM te KRPP. U perdoren te njejtat burime te te dhenave si ne vitin e pare, metodologji e njejet si dhe mjete te njepta te raportimit.

Gjithashtu u ra dakord qe AK qe do te monitorohen vitin e dyte te projektit duhet te jene nga sektoret qeveritare si te nivelit qendror ashtu edhe te atij lokal si dhe ndermarrje publike, si: Ministria e Finances; Ministria e Drejtësise; Ministria e Diaspores; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinore; Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a; Universiteti i

Prishtines; Aeroporti Nderkombetar i Prishtines; Posta dhe Telekomi i Kosoves; Komuna e Fushe Kosves si dhe Komuna e Skenderajt.

2.3 Raporti i kontratave te nenshkuara nga AK

LPP, Neni 87, paragrafi 2.11, percakton qarte KRPP, ne perjegjesine e pergatitjes se formulareve te raportimit qe duhet te plotesohen nga te gjitha AK, ne nivel te vendit dhe dorezohen ne KRPP ne menyre manuale dhe elektronike.

Si fillim, edhe ne vitin e dyte te implementimit te projektit u be nje analize e raporteve te kontratave te nenshkuara te dorezuara ne KRPP, nga 10 autoritetet kontraktuese te zgjedhura per monitorim per vitin 2014. Nga kjo rezultoje, se:

Numri i pergjithshëm i kontratave sipas raporteve te dorezuara nga 10- AK, ne KRPP per vitin 2014 ishte: ***1014 kontrata te nenshkuara e qe arrijne nje vlere te përgjithshme prej 78,437,050.56 euro*** siç eshte e vendsour ne Tabelën 2.

Tabela 2. paraqet AK, te zgjedhura per te u monitoruar ne vitin fiskal 2014. Gjithashtu tabela paraqet edhe numrin e rasteve (aktivitetev) te implementuara nga keto AK gjate vitit 2014 sipas numrit te tyre dhe sipas vleres financiare.

Tabela 2: Totali i kontratave te nenshkuara te 10- AK sipas raporteve te dorezuara ne KRPP:

Autoriteti Kontraktues	Numri total i aktiviteteve/kontratave te nenshkuara per AK	% e aktiviteteve ne rapport me nr. e pergjithshem te aktiviteteve per vitin 2014	Vlera Totale e kontratave per 10- AK (ne euro)	% e vleres totale ne rapport me vleren e pergjithshem te kontratave per vitin 2014
1. Ministria e Financave	67	6.6%	1,101,978.33	1.40%
2. Ministria e Diaspores	58	5.7%	353,483.57	0.45%
3. Komuna e Fushe Kosoves	104	10.3%	2,546,804.03	3.25%
4. Universiteti i	84	8.3%	1,223,337.99	1.56%

Prishtines				
5. Aeroporti Nderkombetare i Prishtines	37	3.6%	436,424.10	0.57%
6. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosoves	244	24.1%	54,225,178.67	69.13%
7. Ministria e Drejtësise	34	3.3%	300,820.58	0.38%
8. KOSTT	97	9.6%	10,941,533.31	13.95%
9. Ministria e Mjedisit & Planifikimit Hapesinore	235	23.2%	4,169,647.28	5.31%
10. Komuna e Skenderajt	54	5.3%	3,137,842.70	4.00%
Totali:	1014	100%	78,437,050.56 euro	100%

Shenim: LPP, kerkon qe AK, duhet te bejne dorezimin e raportit te kontratave te nenshkuara mbredha nje viti ne KRPP. KRPP ka draftuar nje formulare standard te cilin AK duhet te e plotesojne dhe dorezojne ne KRPP. Nga raportet e kontratave te monitoruara rezulton se nga 10-AK, asnjera nuk e ka plotesuar formularin standard te KRPP, ashtu siq kerkohet, dhe eshte gjetur se:

- Ne raporte, mungojne te paraqitura kontratat me vlera minimale. Nga 10-AK, te monitoruara ne 1- AK, nuk ishin te paraqitura kontratat me vlera;
- Jan gjetur gabime ne totalin e per gjithshem te kontratave te nenshkuara ku ne kete total eshte futur edhe vlera e parashikuar e kontratave;
- Mos llogaritja (vendosja) e totalit te kontratave te nenshkuara;
- Ne disa raste shifrat e prokurimit qe kane te bejne me llojin/kategorine e prokurimit, ishin te vendosura gabimisht p.sh kemi te bejme me kontrate te furnizimit derisa eshte vendosur shifra 2. qe ka te beje me kontrate te sherbimeve;
- Gjithashtu ka raste ku ka edhe perzierje te procedurave te prokurimit ku ne numrin e formuar te prokurimit eshte vendosur shifra 6 qe tregon se kemi te bejme me kuotim te cmimeve derisa eshte zhvilluar procedure e hapur;
- Ne raporte mungojne kolonat si lloji i prokurimit apo vlera e prokurimit, qe le te kuptohet se formulari rapporti standard i KRPP eshte modifikuar;
- Ka raste ku numrat rendor te aktiviteteve te prokurimit jane gabim, dhe si resultat nuk mund te dihet saktesisht numri i per gjithshem i aktiviteteve te prokurimit te zhvilluar gjate vitit 2014, ne kete kete AK, pastaj edhe ne nivel te vendit.
- Ne raporte, edhe kete vite, ka raste kur vlera e kontrates se dhene eshte e paraqitur me cmimin per njesi dhe si resultat nuk mund te dihet vlera reala e kontrates perktese. Jan identifikuar edhe edhe gabime teknike ne vendosjen e cmimit te kontrates se dhene p.sh.

eshte gjetur se cmimi i kontrates se dhene eshte 960.00 euro , derisa procedura e zhvilluar e prokurimit eshte procedure e hapur.dhe si rezultat nuk mund te kemi nje shifer te sakte te vleres se kontratave te dhena gjate vitit 2014, per kete AK dhe ne per gjithesi.

- Ne raporte ka raste kur vlera e kontrates eshte e paraqitur si 0.00, derisa te dhenat e tjera tregojne se kemi te bejme me nje aktivitet te prokurimit qe eshte zhvilluar nepermes procedurave te hapur dhe se nuk ka pasur anulim te aktivitetit perkates, ku si rezultat i kesaj nuk mund te kemi nje vlere te sakte te kontratave te dhena/te nenshkuara gjate vitit 2014 edhe ne nivel te vendit;
- Ne raporte ka raste ku cmimi i paraqitur ne reportin e kontratave te nenshkuara dallon nga cmimi i paraqitur ne njoftimin per dhenie te kontrates apo ne kontraten e nenshkuar, dhe si rezultat i kesaj perseri nuk mund te kemi nje shifer te sakte te kontratave te dhena/nenshkuara nga AK gjate vitit 2014.
- Ne raporte ka raste kur shifrat ne kolonen e vleres se dhene te kontrates jane te shkruar gabimisht si gabime teknike.

2.3.1 Totali i kontratave te AK sipas llojit/kategorise se prokurimit

Duke pasur parasysh se ky Indikatore eshte matur nga KRPP, per te gjitha AK ne nivel te vendit, atehere te dhenat jane marrur nga “*Raporti mbi aktivitetet e prokurimit publik ne Kosove per vitin 2014*”, dhe jane si me poshte:

Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 4 dhe grafikonin nr. 6, vlera e kontratave të nënskruara përfurnizime gjatë vitit 2014 arrin në 178,156,399.66€ ose 40,02% te totalit te per gjithshem; vlera e kontratave të nënskruara përshtësime është 52,011,485.30€ ose 11,68 % te totalit te per gjithshem; vlera e kontratave të nënskruara përkonkurs projektimi është 234,327.46€ ose 0,05% te totalit te per gjithshem dhe vlera e kontratave të nënskruara përpunë arrin në 159,335,745.46€, dhe kësaj vlere nëse ja shtojm edhe vlerën e Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit në shumë e planifikuar përvitin 2014, prejë 55,468,528.85€, vlera e kontratave përpunë gjatë vitit 2014 arrinë në 214,804,274,31€ ose 48,25% te totalit te per gjithshem.

Sipas ketij rapporti vlera e per gjithshme e kontratave te nenshkuara gjate vitit 2014 ishte gjithsejt: 445,206,486.45€.

2.3.2 Totali i aktiviteve te prokurimit te 10-AK te monitoruara sipas metodave te prokurimit ne 10-AK

Tabela 3: Totali i aktiviteteve te prokurimit sipas metodave te prokurimit

Nr.	Procedura e prokurimit	Nr. total i kontratave te AK per vitin 2014	% nga Nr. i kontratave
1.	Procedura e hapur	297	29.28%
2.	Procedura e kufizuara	1	0.09%
3.	Konkurs i Projektimit	2	0.20%
4.	Procedura e negociuar pas publikim te kontrates	4	0.40%
5.	Procedura e negociuar pa publikim te kontrates	147 (35 -procedura 112-pune shtese)	14.50%
6.	Procedura e fteses per kuotim	375	36.99%
7.	Procedura e kontrates me vlore minimale	188	18.54 %
	Totali:	1014	100

Shenim: Burimet e te dhenave te paraqitura me larte jane marre nga Raportet e kontratave te nenshkuara nga 10- AK-se (te dorezuara ne KRPP), te monitoruara per vitin 2014. Te dhenat jane perpunuar dhe korigjuar (deri ne nje mase), duke marre parasysh se jane verejtur mangesi gjate kontrollimit te ketyre raporteve, si ne: numrat e kolonave qe tregojne llojin e procedures se prokurimit si dhe llojin e prokurimit nuk jane vendosur sakte; gabime teknike ne perllogaritjen e cmimeve te dhena te kontratave; nuk eshte perdonur si duhet formulari standard i kontratave te nenshkuara i preqatitur dhe zyrtarizuar nga KRPP, ka pasur modifikime (si rasti i MF ku rapporti s'ka fare numer te procedurave te prokurimit ose total te kontratave te nenshkuar, mungon krejt nje pjese me udhezime ose dhe rapporti i MeD i cili nga formati standard ne exel eshte bartur ne word etj.).

Numri i kontratave te lidhura nga AK-te, sipas procedurave te prokurimit shprehur ne vlera financiare

Duke pasur parasysh se ky Indikatore eshte matur nga KRPP per te gjitha AK ne nivel te vendit, atehere te dhenat jane marrur nga “Raporti mbi aktivitetet e prokurimit publik ne Kosove per vitin 2014”, dhe jane si me poshte:

- Procedura te hapura: 282,717,895.34€
- Procedura te kufizuara: 281,264.21€
- Konkurs te projektimit: 47,883.00€
- Procedura te negociuara pas publikimit te kontrates: 31,924,923.00€

- Procedura te negociuara pa publikim te kontrates:	50,591,999.50€
- Procedura te kuotimit te cmimeve:	21,888,064.14€
- Procedura te vleres minimale:	2,285,928.41€

Gjithsejt: 389,737,957.60 euro (pa vleren e autostrades prej: 55,468,528.85 euro).

Ose rezultati i paraqitur me larte shprehur ne perqindje, si:

- Procedura te hapura:	72.55%
- Procedura te kufizuara:	0.07%
- Konkurs te projektimit:	0.01%
- Procedura te negociuara pas publikimit te kontrates:	8.19%
- Procedura te negociuara pa publikim te kontrates:	12.98%
- Procedura te kuotimit te cmimeve:	5.62%
- Procedura te vleres minimale:	0.58%

2.4 Inventari i rasteve te monitoruara te prokurimit

Mbledhja e te dhenave per kontratat e prokurimit u be per vitet 2014/2015. Viti 2015 u mor per raste qe kanë filluar në 2014 dhe qe ne vitin 2015 jane ne procesin e zbatimit/implementimit te kontratave.

Zgjedhja e aktiviteve të prokurimit qe duhet të monitorohen te AK te cekura me larte, eshte bere duke u bazuar ne te dhenat nga raportet vjetore të punes se AK dorezuar ne KRPP (kerkese kjo ligjore). Zgjedhja e lendeve per te u monitoruar u be sipas: kategorise se prokurimit (mallra, shërbime dhe punë), metodave te prokurimeve (e hapur, e kufizuar, konkurs projektimi, negociuar pas publikimit te kontrates, e negociuar pa publikim te kontrates dhe ftese per kuotim) dhe vleres se kontratave (vogel, mesme dhe e madhe, me perjashtim të atyre me vlera minimale).

Qe te kemi nje vlefshmeri dhe besueshmeri te te dhenave, ekipet e projektit vizituan AK, ku ishte e nevojshem apo kerkuan te dhenat relevante shtese nga AK dhe zyrtaret e prokurimit perkatese.

Nga kjo rezuljoje se u monitoruan 80 aktivitete te prokurimit, prej tyre, sipas procedurave

- procedura te hapura- 61 raste;
- procedura te negociuara pa publikim te kontrates 10 aktivite te prokurimit (prej tyre: 4- raste te monitoruara pune shtese);
- Procedura te fteses per kuotim -9 raste te monitoruara.

Shenim: Nga 60 aktivitetet e prokurimit te zhvilluara me procedure te hapur ne 15 prej tyre eshte perdonur procedura e kontrates publike kornize.

2.5 Instrumentet/mjetet e mbledhjes se te dhenave

Instrumentet/mjete ne vijim janë perdorur për te mbledhur te dhenat e paraqitura ne kete raport:

- Pyetesori per rastet e monitoruara te prokurimit (Aneksi-I)
- Baze elektronike per grumbullimin dhe perpunimin e te dhenave te mbledhura nga monitorimi (Aneksi-II)

Pytesori per rastet e monitoruara te prokurimit, i pregaditur ne vitin e pare te projektit u perditesua sipas nevojes se paraqitur nga aktivitetet e prokurimit te monitoruara.

Per nevoja te Departamentit te Monitorimit te KRPP-DM, u draftua nje shablon per nje raport te monitorimit per AK, i cili filloje te perdoret nga zyrtare e DM qe nga periudha e dyte e vitit 2015.

Gjithashtu gjate vitet te dyte te matjes se performances u be edhe perditesimi i formularit standard te Raportit te kontratave te nenshkuara i leshuar nga KRPP dhe i cili do te perdoret per mbledhjen e te dhenave te kontratave te nenshkuara nga te gjitha AK, ne nivel te vendit.

2.6 Burimet e te dhenave

Burimet e te dhenave per MP&MP, per vitin e pare u moren:

- Nga planifikimet finale te prokurimit te AK
- nga raportet vjetore te kontratave te nenshkuara nga AK
- Nga rastet e monitoruara te prokurimeve nga AK
- Nga AQP
- Nga OSHP
- Nga web-siti zyrtare i prokurimit publik te KRPP

Kapitulli III

3. Te gjeturat nga MP&MP

3.1 Informacioni baze mbi kontratatat e monitoruara

Ky seksion paraqet resultatet nga MP&MP, qe eshte bazuar ne nje total prej 80 aktiviteteve te prokurimit te monitoruar (prej tyre 97 kontrata te nenshkuara duke marre parasysh ketu se disa aktivite te prokurimit te monitoruara ishin ta ndara ne Lote), ne 10 - AK. Një pasqyre e informacionit baze mbi kontratat mostra eshte paraqitur me larte (shif. Kapitulli

II), dhe ketu jane paraqitur rezultatet sipas fushes kryesore te performances, indikatoreve kyç te performances dhe nen-indikatoreve (treguesve).

3.2 Te gjeturat sipas Indikatoreve kyç te performances

3.2.1 Faza para-tenderimit

Nen kete zone kyçë te performances, treguesit dhe rezultatet ne vijim do të jene te matur, ne:

- Percaktimi i vleres se parashikuar te kontrates
- Planifikimi i prokurimit
- Vlera vs llojet e procedurave te prokurimit
- Pregaditja e dokumenteve te tenderimit

Percaktimi i vleres se parashikuar te kontrates –indikatore kyç, ndersa si sub-indikator:

- a eshte bere caktimi i vleres se parashikuar te kontrates;
- si eshte bere kalkulimi i vleres se parashikuar te kontrates;
- a eshte marre ne konsiderate kohezgjatja e kontrates gjate kalkulimit te vleres se parashikuar te kontrates;
- diferenca ne mes vleres se parashikuar dhe vleres se dhene te kontrates.

Nga 80-rastet e monitoruara (aktivite te prokurimit te zhvilluara), vlera e parashikuar e kontrates ishte e caktuar (vendosur), paraprakisht ne 78 - raste, ndersa nuk ishte e caktuar paraprakisht ne 2-raste te monitoruar ose e shprehur ne perqindje: ishte e caktura ne 97.5 % ndersa nuk ishte e caktuar ne 2.5 % - te rasteve te monitoruara.

Nga 80 - rastet e monitoruara, ne 70 - raste te monitoruara te kontratave te zhvilluara me procedura te hapura dhe te fteses per kuotim (duke i perjashtuar ketu aktivitet e prokurimit te zhvilluara me procedure te negociuar pa publikim te kontrates), eshte gjetur se: vlera e parashikuar e kontrates ka qene e caktur nga te dhenat e AK, perkatesisht kontratave paraprake si dhe ose eshte bere nje hulumtim paraprak i tregut ne disa raste sipas stafit te prokurimit por qe kan munguar te dhenat per ta vertetuar kete.

Nga 80-rastet e monitoruara, ne 70-rastet e monitoruara te kontratave te zhvilluara me procedura te hapura dhe te fteses per kuotim (duke i perjashtuar ketu aktivitet e prokurimit te zhvilluara me procedure te negociuar pa publikim te kontrates), ne 68 –raste ose ne 97.15 % te rasteve, ne caktimin e vleres se parashikuar te kontrates, AK, kane marre ne konsiderate kohezgjatjen e implementimit.Ndersa ne 2.85% - te rasteve te monitoruara, AK, nuk kan marre ne konsiderim kohezgjatja e implementimit te kontrates por vetem duke e kalkular vleren paqralllogaritare te kontratave vetem per 1-vite derisa kontratat e neshkruara ishin kontrata kornize me afat te kohezgjatjes 2-3 vjecare.

Nga 80-rastet e monitoruara, ne 70-rastet e monitoruara te kontratave te zhvilluara me procedura te hapura dhe fteses per kuotim (duke i perjashtuar ketu aktivitetet e prokurimit te zhvilluara me procedure te negociuar pa publikim te kontrates), eshte gjetur se: ne 50-rastet te monitoruara ose 71.43% te rasteve, diferenca ne mes vleres se parashikuar te kontrates dhe te vleres se dhene te kontrates eshte mesatarja 20.58 %, qe d.m.th se vlera e kontrates se dhene eshte me e madhe se ajo e parashikuara; ne 16-rastet e tjera te monitoruara ose ne 22.86 % - te rasteve, nuk ishte e mundur nxerrja e mesatares se differences se larsekur per faktin se kontratat e dhena ishin vetem sipas cmimit njesi, pa e percaktuar sasin e perafert dhe totalin e vleres se kontrates perkatese te dhene; ne 4-rastet e tjera ose ne 5.71%, nuk ishte e mundur llogaritja e differences ne mes vleres se parashikuar dhe asaj te dhene te kontrates per faktin se ne 2-raste, vlera e kontratave te dhena ishte vetem per nje (1) lot derisa i gjitha aktiviteti i prokurimit ishte i ndare ne me shume lote te cilat nuk kishin rezultuar me nenshkrim te kontratave si dhe ne 2-raste, te tjera nuk ishte e caktuar paraprakisht vlera e parashikuar e kontrates (sic u cek edhe me larte).

Planifikimi i prokurimit –indikatore kyc, ndersa si sub-indikator:

LPP, percakton se planifikimi final i prokurimit mbetet dokument sekret ne kuader te AK qe d.m.th nuk eshte publik per palet e interesuara, ndersa duhet te i dorezohet vetem AQP.

- a eshte rasti i monitoruar i prokurimit pjese e planifikimit final te prokurimit;
- rasti i monitoruar a ka nje plan/afat kohore paraprak te vendosur per periudhen kohore te implementimit dhe nese po, a eshte respektuar ky afat.

Nga 80-rastet e monitoruara, ne 76-rastet (duke i perjashtuar ketu 4-raste te monitoruara si kontrata shtese), te planifikuara ne planifikimin final te prokurimit jane 51 raste ose 67.10 % -te rasteve,ndersa te pa-planifikuara dhe/ose duke mos e specifikuar aktivitetin perkates te prokurimit por vetem si pershkrim i perjithshem jane 25-raste ose 32.90 % - te rasteve te monitoruara.

Nga 80-rastet e monitoruara, ne 76-rastet (duke i perjashtuar ketu 4-raste te monitoruara si kontrata shtese), ne 51 - rastet e planifikuara ne planifikimin final te prokurimit te AK, afat kohore te implementimit te aktivitetit perkates te prokurimit ishin te vendosura ne planifikimin final ne 24-raste ose ne 47.06%- te rasteve. Ndersa ne 27 –raste ose 52.94 % - te rasteve nuk kishin plan te prokurimit dhe ose nuk kishin respektuar planin e implementimit te prokurimit nese kane pasur (ne planifikimin final te prokurimit vendoset afati kohor qe perfshire periudhen janar-dhjetor, pa specifikuar afatet se kur do te behet iniciimi i aktivitetit perkates te prokurimit dhe deri ne realizimin e plote te kontrates).Rezultatet e perllogaritura me larte perfshijne vetem ato plane te implementimit te prokurimit deri ne nenshkrimin e kontrates sepse nuk ka te dhena per asnje aktivitet te prokurimit deri ne realizimin e plote te kontrates perkatese. Nje avancim ne lidhje me kete ceshtje eshte bere me plotesim/modifikimin e dokumentit: rapporti vjetor i kontratave te nenshkruar nga AK, dokument ky zyrtare i leshuar nga KRPP. Ky dokument eshte plotesuar duke vendosur indikatore shtese mites qe ne lidhje me kete ceshtje do te matet edhe koha e realizimit te nje kontrate.

Rezultatet nga matja e ketij Indikatori shume te rendesishem kane treguar se AK nuk bejne nje planifikim per secilin aktivitet duke i nderlidhur ato me buxhetin perkates dhe me planin e punes (i cili rralle here qe definohet) dhe keshtu aktivitetet shpesh implementohen jasht buxhetit te aprovuar.

Lloji i procedurave te prokurimit - indikatore kyc

Ne menyre qe te kemi nje pasqyre sa me reale te perdonimit te procedurave te prokurimit,te dhenat per kete indikatore jane marrur nga raportet e kontratave te nenshkuara dhe dorezuara ne KRPP nga 10-AK per vitin 2014. Nga analizimi i ketyre te dhenave eshte gjetur se: nga 10-AK te monitoruara, raportet e pregaditura me te gjitha kontratat e nenshkuara (me vlera te medha, mesme, vogla dhe minimale te percaktuar me LPP), ishin te perfshira ne gjithsejt: 9-AK te monitoruara ndersa ne 1-AK, nuk ishin te perfshira (ne raportin e vitit te kaluar kjo e dhene ishte: kontrat me vlera minimale te perfshira ne 7-AK, te monitoruara ndersa ne 3-AK, te tjera nuk ishin te perfshira/pasqyruara kontratat me vlera minimale). Nga kjo e dhene rezulton se te dhenat e pasqyruara dhe pastaj te nxjerra nga raportet vjetore te kontratave te nenshkuara nga AK, dhe dorezuara ne KRPP, mund te mos jene te plota.

Ndersa nga 10-AK, gjithsejt aktivitete te prokurimit te zhvilluara ishin 1014, ku prej tyre eshte gjetur se perdonimi i procedurave te prokurimit eshte bere si ne vijim:

- Procedura te hapur: 297- aktivitete te prokurimit
- Procedura te kufizuara: 1-aktivitet i prokurimit
- Konkurs i projektimit: 2-aktivitete te prokurimit
- Procedure e negociuar pas publikimit te kontrates: 4-aktivitete te prokurimit
- procedure e negociuar pa publikimit te kontrates: 147 aktivitete te prokurimit (prej tyre 112-kontrata shtese)
- procedura e kuotimit te cmimeve: 375-aktivitete te prokurimit
- procedura e vleres minimale: 188-aktivitete te prokurimit.

Shenim: Ky indikator ishte relevant te matej sepse ne: Raporti mbi aktivitetet e prokurimit publik ne Kosove per vitin 2014, kjo e dhene nuk eshte e paraqitur.

Procedurat e prokurimit te perdonura nga 10-AK, shprehur ne perqindje:

- | | |
